



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME PLENARE E KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 7.04. 2011

SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 7.04. 2011. GODINE

PRILL – APRIL  
2011

**E enjte, më 7. 04. 2011,**

**Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Mysafirë të nderuar,

Të nderuar qytetarë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të grupit prej 40 deputetëve.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 101 deputetë, andaj fillojmë me punën e mbledhjes plenare.

Seanca e sotme do të punojë me këtë rend të ditës:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe
2. Rezoluta në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes në mes të z.Behxhet Pacolli, z.Isa Mustafa dhe z.Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës**

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 27 të Rregullores së Kuvendit, për president të Republikës së Kosovës janë nominuarë dy kandidatë: zonja Atifete Jahjaga dhe zonjusha Suzan Novobërdaliu.

Ftoj kryetarin e Grupit të Partisë Demokratike, deputetin Adem Grabovci, për të paraqitur kandidaten Atifete Jahjaga.

Të pranishëm në sallë janë 110 deputetë.

ADEM GRAGOVCI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që në emër të 42 deputetëve të nënshkruar të paraqes kandidaturën për presidente të vendit, zonjën Atifete Jahjaga. Po ashtu, edhe në emër të 31 deputetëve të poshtëshënuar, paraqes edhe kandidaturën e zonjushës Suzana Novobërdaliu për presidente të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për verifikimin e kushteve të kandidateve të nominuara për president, propozoj që Kuvendi të autorizojë në Nënkomisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, në këtë përbërje:

1. Deputeti, Armend Zemaj, kryetar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike,
2. Behar Selimi, zëvendëskryetar, Grupi i Partisë Demokratike,
3. Albulena Haxhiu, anëtare e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”

4. Ardian Gjini, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,
5. Ibrahim Makolli, kryetari i Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovën e Re,
6. Jasmina Zhivković, anëtare e Grupit Parlamentar të SLS-së, dhe
7. Mufera Shinik, anëtare e Grupit Parlamentar “6+”.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për autorizimin e këtij nënkomisioni.

Kush është “për”? A ka “kundër”? Faleminderit! A ka abstenim?

Konstatohet se Kuvendi autorizoi në Nënkomisionin për verifikimin e plotësimit të kushteve të kandidateve për president, me shumicën absolute të deputetëve.

Kërkoj nga ky nënkomision që menjëherë të mbledhen në sallën N-10 dhe Kuvendit t’ia paraqet raportin.

Pauzë 15 minuta.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Ftoj kryetarin e Nënkomisionit, zotin Armend Zemaj, që Kuvendit t’ia paraqet raportin.

ARMEND ZEMAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Zoti kryeministër, Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit paraqet Raport për verifikimin e kushteve të kandidateve të nominuara për presidente të Republikës së Kosovës.

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, në pajtim me Vendimin e seancës plenare, datë 7 prill 2011, shqyrtoi dokumentacionin e kandidateve të nominuara për president të Republikës së Kosovës, zonjës Atifete Jahjaga dhe zonjushës Suzan Novobrdaliu, lidhur me plotësimin e kushteve të parapara me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Nënkomisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar konstatoi se kandidatet e nominuara për presidente të Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga dhe zonjusha Suzan Novobrdalii i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 7 prill 2011

Kryetari i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit,  
Armend Zemaj,

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë! Radha e diskutimeve sipas grupeve parlamentare.

Kush e do fjalën nga Grupi Parlamentar i partisë Demokratike? Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah kandidaturën e kandidates, e cila ka dalë në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar në mes të tre përfaqësuesve të partive politike, zonjën Atifete Jahjaga, dhe i fton edhe deputetët e tjerë që të përkrahin dhe të votojnë për këtë kandidaturë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, po ashtu, përkrah kandidaturën e zonjës Atifete Jahjaga për presidente të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta votojë sonte Atifete Jahjagën për presidente të vendit, sepse kjo kandidate në vend që të jetë mishërim dhe përfaqësim i vullnetit të popullit, do të jetë një produkt i një marrëveshjeje partiake, që i jep fund Kosovës si Republikë.

Rendi republikan i ndërton praktikat institucionale mbi parimin e kushtetutshmërisë që e përfshinë interesin qytetarë, e jo siç ndodhi mbrëmë nga ambiciet e pakufishme për pushtet.

Marrëveshja e arritur dje ia zgjatë jetën kësaj qeverisje minimalisht për dy vjet e gjysmë. Këto dy vjet e gjysmë janë problemi e jo zgjidhja, sepse në këto dy vjet e gjysmë do të synojnë që ta shesin PTK-në, KEK-un dhe Trepçën, si dhe t'i përmbyllin bisedimet me Serbinë, të cilat e bosnizojnë vendin tonë.

Kjo marrëveshje nuk është zgjidhje sepse është shumë më tepër legjitimim i asaj çfarë kishim deri më tani, se sa zgjedhje për të ardhmen.

Neni i parë i Marrëveshjes ia jep Pacollit cilësinë e udhëheqësit të AKR-së, kur ky s'është më i tillë, nuk e dimë a mos ka nënshkruar vallë në emër të Mabeteks-it.

Sa i përket kandidates së propozuar për president, për konceptet e saj politike nuk mund të flasim edhe aq shumë, sepse askush nuk e di se çfarë vizioni ka ajo për shtetin e Kosovës, për interesat tona shtetërore dhe kombëtare, ekonomike e shoqërore.

Atë nuk e njohin shumica e qytetarëve të vendit. Si mund t'i përfaqësoj ajo këta qytetarë, si mund të të përfaqësoj dikush që ti nuk e njeh fare dhe të cilit nuk ia ke dëgjuar as edhe një intervistë a qëndrim publik për planin e Ahtisarit, për negociatat me Serbinë, për privatizimin e PTK-së e për probleme të tjera të Kosovës.

Megjithatë, vetë fakti që ajo punon me urdhra dhe ka pranuar të jetë rezultat i një marrëveshje partiake, arbitrare dhe antikushtetuese është i mjaftueshëm për të kuptuar se ajo do të jetë në shërbim të Qeverisë Thaçi e jo në funksion të qytetarëve të Kosovës.

Kandidatja formale, Suzana Novobërdaliu, është simulim i demokracisë dhe tregon që pluralizmi në Kosovë është asgjë tjetër përveç improvizim.

Procesi i zgjedhjes mes dy kandidateve nuk është korrektë dhe as i drejtë për shkak se ambasadori Dell, që e nënshkroi dje po ashtu marrëveshjen, i thuri aq shumë lavde Atifetes, sa që e zhduki tërë hapësirën e zgjedhjes. Ky është realisht tender njëburimor, ku fituesi tashmë po dihet.

Kur është puna për 8 deri 9 muaj, e gjejnë një grua për kandidate, madje edhe kundërkandidate ia kanë vendosur një grua, ky është diskriminim ndaj grave.

Mbrëmë koalicionit Thaçi - Pacolli i u shtua edhe Isa Mustafa. Ky njeri ia fali këtij koalicioni të ngritur mbi manipulimin e zgjedhjeve, 27 deputetë për legjitimitetin e tij të munguar. Ai që fliste për ditë të numëruara të Qeverisë Thaçi, ia dha asaj 1000 ditë të tjera.

Isa Mustafa e ka bërë po të njëjtën gjë, që e kishte bërë edhe paraardhësi i tij, Sejdiu, të cilin Isa Mustafa e rrëzoi duke u thirr në ndryshime.

Marrëveshja e arritur i ka paraqitur tri qëllime: Presidenti konsesual, reforma kushtetuese për klauzolën e zgjedhjes së presidentit dhe ndryshimin e Ligjit zgjedhor. Për qytetarët e Kosovës këto tri synime janë dushk për gogla, të tria këto synime për çfarëdo pushteti janë detyrime, e jo diçka me të cilat bëhet kompromise. Asnjë parti politike nuk ka të drejtë që ta legjitimojë një pushtet të padrejtë në emër të qëllimeve që janë obligative për të dhe me të cilat nuk bëhet kompromis. Kjo nguti me të cilën po procedohet për zgjedhjen e presidentit, është nguti kriminale. Asnjëherë nuk i është ngutur që ta diskutojmë çështjen e Mitrovicës së ndarë, strukturave paralele të Serbisë, kufijve që nuk mbrohen, varfërisë, papunësisë e tjerë, por ju ngutet për president, sa që për disa orë marrin një vendim për seancë. Pra, vetëm për pushtet ju ngutet, asnjëherë për qytetarët e shtetin.

Edhe Komisioni për reformën e zgjedhjeve presidenciale, e edhe ai për reformim të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, të dyja këto që dolën nga marrëveshja e mbrëmshme, thonë

se “do të synojnë ta përfundojnë punën e vet”. Ky ishte ecitat, pra “do të synojnë ta përfundojnë punën e vet brenda 6 deri 9 muaj, përkatësisht 8 deri në 12 muaj”. Ndonëse faza e dytë është e afatizuar, faza e parë nuk ka kurrfarë afati aty. Ky detaj pra është vetë djalli në këtë marrëveshje. Në emër të kushtetutës po shkelet kushtetuta, këta njerëz në emër të sovranitetit, shkojnë në negociata me Serbinë, në emër të zhvillimit ekonomik, na i shesin pasuritë tona publike dhe në emër të kombit, e shesin kombin.

Këto janë arsytet tona politike pse nuk e votojmë Atifete Jahjagajn për presidente, kurse sa i përket kundërkandidates së saj, për të as që ia vlen të diskutohet, meqë kemi të bëjmë me një marionetë, që ka pranuar me vullnet të lirë të vihet në skenë vetëm sa për t’u plotësuar kushti formal për kandidatin e dytë.

Ne, po ashtu, e kundërshtojmë rezolutën që veç për sa sy e faqe po i ofrohet këtij Kuvendi për miratimin e një marrëveshje që tashmë është arritur jashtë Kuvendit. Këtu po kërkon ta formalizoni pazarin tuaj, që tashmë e keni bërë. Prandaj, ne e lëshojmë sallën e Kuvendit për shkak se nuk duam të jemi pjesë e kësaj talljeje me institucionet e vendit dhe të kësaj talljeje me qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të jetë në sallë gjatë procedurës së votimit për president të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovën e Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Koalicioni për Kosovë të Re, me votën e vet do të përcaktohet për kandidat dhe natyrisht mbështet marrëveshjen e arritur në mes të liderëve të partive politike. Por, unë këtu po ashtu dua të shtroj edhe një çështje tjetër, sepse kujtoj që në ndërtim të institucioneve duhet të tregojmë edhe një kulturë institucionale dhe të pranishëm në këtë sallë, qoftë edhe si mysafirë, nuk po e shoh ish presidentin, të dy ish presidentët e vendit, që besoj se do të duhej të ishin. Ne duhet edhe në ndërtim të institucioneve të tregojmë se megjithatë në këtë vend, përkundër vështirësive që kemi, do të duhej të ketë një kulturë institucionale. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Sasha Rashiq e ka fjalën.

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Parlamentarna grupa je svoju podršku izrazila svojim potpisima za kandidaturu sa predsednika Kosova i učestvovaćemo u glasanju za predsednika Kosova.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedniče!

Parlamentarna grupa „6+“ podržace sporazum koji je potpisan o kandidaturi Atifete Jahjaga, tako da ćemo učestvovati u glasanju.

KRYETARI: Faleminderit!

Të lajmëruar për diskutim nuk ka. Vazhdojmë.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj me procedurën për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë. Zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat e votave të deputetëve të Kuvendit. Nëse asnjëri kandidat nuk i merr dy të tretat e votave në dy votimet e para, zhvillohet votimi i tretë mes dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e dytë. kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve në votim e tretë, zgjedhet president i Republikës së Kosovës. Nëse edhe në votimin e tretë asnjëri nga kandidatët nuk zgjedhet president i Republikës, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja për Kuvend bëhen brenda 45 ditëve nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Mandati i presidentit është 5 vjet.

Meqë zgjedhja e presidentit bëhet me votim të fshehtë, kjo nënkupton krijimin e një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës. Andaj, para se të procedojmë me votimin e fshehtë, ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Radha është e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozojmë për anëtar të komisionit Berat Buzhalën.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Sabri Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Propozojmë Armend Zemajn.

KRYETARI: Faleminderit!

Grupi parlamentar “Vetëvendosjes” e lëshoi sallën.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ka kandidat? Nuk ka kandidat.

Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Nga radhët e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, propozojmë deputetin Jeton Svirca.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputeti Sasha Rashiq. Cili është kandidati për komision?

SAŠA RAŠIĆ: Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke predlaže Jelenu Bontić, za člana ove komisije. Jelena Bontić.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”. Myfera Shinik e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: “6+” Grup adına da Duda Balje’ yi öneriyoruz.

KRYETARI: Faleminderit!

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohet për emërimin e anëtarëve të Komisionit votues. Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? Nuk ka. Konstatohet se Kuvendi emëroi anëtarët në Komisionin votues për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Anëtarët e komisionit le t’i zënë vendet e tyre!

Në sallë janë 101 deputetë. Edhe njëherë, në sallë janë 101 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Fillojmë me thirrjen e deputetëve, veç e veç. Fillojmë me Adem Grabovcin, Afërdita Berisha – Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharemaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu – Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kada Bujupi, Duda Bale, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Krivan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florim Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinković, Njazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Ibrahim Makolli, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi...

*Drejtimitin e seancës e merr z. Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit*

...Jasmina Zhivković, Jelena Bontić, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumniye Morina, Lutfi Haziri, Lutfi Zharku Fikrim Damka, Kurtan Kajtazhi, Suzan Novobrdaliu, Mufera Srbica – Shinik, Muhamet Mstafa, Murselj Haljilji, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Nekibe Kelmendi, mungon, Saša Milosavljević, Petar Miletić, Rada Trajković, nuk është, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimmi, nuk është, Rit Hajzeraj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Saša Djokić, Saša Rašić, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todorović, Sreten Ivanović, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Savić, Vesna Mikić, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi,

Vjosa Osmani, Valbona Dobra, Xhevahire Izmak, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti, Xhavit Haliti.

Ftoj Komisionin që ta bëjë përzierjen e votave dhe të fillojë numërimin.

Drejtimitin e seancës e rimerr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Regjia, foltores mikrofonin!

BERAT BUZHALA:

- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,

- Atifeate jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Suzan Novobërdalia,
- Atifete Jahjaga,
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,
- Atifeate Jahjaga,
- Suzan Novobrdalia,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Suzan Novobërdalia,
- Suzan Novobërdalia,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,
- Suzan Novobrdaliija,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- E pavlefshme
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Suzan Novobrdalia,
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,

- E pavlerfshme,
- Suzan Novobrdalia,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Suzan Novobërdalia
- Suzan Novobërdalia
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga
- E pavlefshme,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,
- Suzan Novobërdalija,
- Atifete Jahjaga,
- Atifete Jahjaga,

Deputeti Berat Buzha - Komisioni votues për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, jep këtë

### **Raport mbi rezultatet e votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës**

Në mbështetje të neneve 65, pika 7 dhe 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Seancës plenare, datë 7 prill, në përbërje nga:

1. Berat Buzhala,
2. Armend Zemaj,
3. Jeton Svirca,
4. Jelena Bontiq, dhe
5. Duda Balje.

Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e presidentit të Republikës, në Seancën plenare të mbajtur më 7 prill 2011, konstaton si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 100 deputetë. Për Atifete Jahjaga kanë votuar 80 deputetë, për Suzan Novobrdalija kanë votuar 10 deputetë, të pavlefshme janë 10 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se Atifete Jahjaga zgjedhet Presidente e Republikës së Kosovës.

(Duartrokitje)

KRYETARI: Ftoj Presidenten e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, që të bëj betimin para deputetëve të Kuvendit.

PRESIDENTJA ATIFETE JAHJAGA: “Betohe se tërë fuqinë time do t’ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, sigurimit të lirive dhe të drejtave njerëzore e qytetare, respektimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjes së paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe me ndërgjegje e përgjegjësi do t’i kryej të gjitha detyrimet e mia“.

(Duartrokitje)

KRYETARI: Lus deputetët që të ngriten në këmbë. Kërkoj nga regjia që të japë intonimin e himnit kombëtar.

(Ekzekutohet himni)

(Duartrokitje)

KRYETARI: Ftoj presidenten që ta marrë fjalën.

PRESIDENTJA ATIFETE JAHJAGA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Të nderuar ambasadorë,

Honorable ambassadors, Dear guests,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Poštovani građani Republike Kosovo,

Zgjedhja ime Presidente e Republikës së Kosovës shpreh qëndrimin konsensual dhe marrëveshjen ndërmjet partive politike parlamentare për kapërcimin e krizës politike dhe për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për të ardhmen e vendit, duke bërë ndryshimet e nevojshme në Kushtetutën e Kosovës dhe në sistemin zgjedhor, si dhe duke caktuar një agjendë të qartë të veprimeve institucionale për tre vjetët e ardhshëm.

Deri dje nuk kam menduar kurrë për të marrë një pozitë të lartë udhëheqëse politike. Por, ashtu si shumë nga bashkëqytetarët e mi, isha e gatshme të shërbej kur dhe ku të më ftojë vendi. I kam përkushtuar jetën time qytetarëve të këtij vendi në ndërtimin e njërit prej institucioneve më të rëndësishme demokratike. Gjatë 11 vjetëve të kaluara i kam shërbyer vendit tim në Policinë e Kosovës, ku kam filluar si fillestare dhe e lë sot si zëvendësdrejtoreshe e përgjithshme e Policisë.

Karriera ime pasqyron ndryshimet nëpër të cilat ka kaluar Kosova gjatë dekadës së shkuar. Kam përjetuar të gjitha sfidat që kanë çuar në pavarësinë e Kosovës. Jam krenare që jam angazhuar në krijimin e ndërtimit të njërit prej institucioneve më të respektuara të Kosovës. Jam e nderuar që kam zhvilluar dhe udhëhequr Policinë e Kosovës, një forcë të fuqishme dhe të aftë që mishëron vlerat e Kosovës, një vendi demokratik dhe multietnik.

Kosovo jeste nezavisna demokratska i multietnička država.

Detyra më sfiduese në karrierën time gjer tani do të jetë detyra e Presidentes të vendit. Kam vullnet dhe vetëbesim se së bashku do t'ia dalim, që të bëjmë ndryshime të mëdha dhe përparim për vendin tonë. Dëshiroj të jemi pjesë e këtij përparimi ashtu si edhe Ju, si përfaqësuese e një gjenerate të re, të udhëheqësve të Kosovës, të gatshëm të ndërtojnë mbi sukseset e atyre që ishin para nesh dhe që udhëhoqën këtë vend dhe popullin drejt shekullit 21.

Kam besim në Kosovën, kam besim në këtë Qeveri dhe kam besim dhe shpresë për qytetarët e vendit tim se do të përmbushim të gjitha objektivat tona. Si Presidente e vendit do të jem garante e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, faktor unifikues, e paanshme politikisht, mbrojtëse dhe përfaqësuese e interesave të Kosovës, shtet sovran dhe i pavarur, përfaqësuese e të gjithë qytetarëve, pa dallim kombi, feje, race a gjinie.

Gjatë shërbimit tim në Policinë e Kosovës iu kam përmbajtur vlerave të cilat e bëjnë Kosovën unike dhe kam mbrojtur të drejtat e secilit individ, pavarësisht përkatësisë së vet, dhe tani si Presidente, kjo përgjegjësi është edhe më thelbësore dhe më domethënëse, duke e forcuar atë që e nisëm kur Kosova e shpalli pavarësinë. Si Presidente e vendit, do të përpiqem çdo ditë të sigurohem se Kosova po i dëshmon vlerat më të mira demokratike të pavarësisë dhe të Kushtetutës.

Të nderuar deputetë,

Kosova kapërceu një rrugë të vështirë, por të lavdishme për shpalljen e pavarësisë dhe në ndërtim të shtetit për të cilin shumë breza të bijve dhe të bijave më të mirë të Kosovës u sakrifikuan, duke mbajtur përherë të gjallë idenë e lirisë, idenë e demokracisë, idenë e dinjitetit dhe të barazisë ndërmjet popujve.

Ideali i të gjithë qytetarëve të Kosovës është anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe miqësia e përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë rrugë ne po punojmë vazhdimisht për të përmbushur të gjitha standardet e nevojshme, sidomos në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, në sundimin e ligjit, në arritjen e objektivave të larta në arsim, shëndetësi, sidomos në zhvillimin ekonomik, për t'iu siguruar qytetarëve një jetë

të mirë, një jetë të qetë dhe të prosperueshme të një normaliteti evropian. Unë besoj dhe do të angazhohem që ne të gjithë së bashku t'i realizojmë synimet tona. Unë besoj dhe e di se ëndrrat tona një ditë të afërme do t'i bëjmë realitet. Këtë besim e mbështes te forca e popullit, te mendja dhe vullneti i të rinjve dhe të rejave të Kosovës.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Së bashku me miqtë tanë ndërkombëtarë ne kemi nisur një proces dialogu me Serbinë. Ky është një proces krejt normal ndërmjet vendeve që kanë pasur mosmarrëveshje dhe konflikt në të kaluarën. Në këtë proces të dialogut ne, të dy vendet fqinje, që ishim të detyruar ta ndajmë të shkuarën, do të jemi të detyruar ta ndajmë edhe të ardhmen. Pasi nuk mund ta ndryshojmë të kaluarën, ne do të ndërtojmë të ardhmen, duke mësuar nga gabimet e të shkuarës. Dialogu do të ketë sukses. Pas përfundimit të tij, rajoni do t'i kthehet paqes dhe stabilitetit. Kosova dhe Serbia do të kenë rrugën e qartë të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke ndihmuar e jo duke penguar njëri-tjetrin. Qytetarët e të dyja vendeve do t'i kthehen jetës normale, bashkëpunimit dhe zhvillimit që do t'u sigurojë një ardhmëri të qetë dhe të mirë. Të gjitha zgjidhjet nga dialogu ndërmjet palëve, duke përfutur të gjithë, do të jenë evropiane, që do të kenë për bazë praktikën dhe përvojat më të mira të Bashkimit Evropian.

Kosova shtet i lirë dhe i pavarur është faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë, që zhvillon marrëdhënie të mira dhe fqinjësore me të gjitha vendet. Kosova do të ketë një rol më aktiv në politikën e jashtme, duke u bërë anëtare në nisma dhe në organizata rajonale dhe botërore, duke rritur numrin e njohjeve dhe duke vendosur marrëdhënie diplomatike, duke bërë marrëveshje bilaterale dhe shumëpalëshe dhe duke krijuar rrethanat e brendshme dhe të jashtme që sa më shpejt Kosova të bëhet anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Me politikën tonë të urtë e të përgjegjshme do të dëshmojmë para vetes dhe përpara botës se ekzistojnë të gjitha arsyet që çdo shtet ta njohë Kosovën e pavarur, si një realitet të pakthyesëm, si një faktor paqeje dhe stabiliteti. Marrëveshja ndërmjet subjekteve politike e dëshmon përgjegjësinë e mandatit të gjithë neve që na ka dhënë populli, e dëshmon përkushtimin që interesat e vendit janë mbi të gjitha.

Të nderuar deputetë,

Ky Kuvend sapo miratoi buxhetin, i cili do të jetë në funksion të zhvillimit. Kështu, duke rritur pagat dhe duke rritur mirëqenien, ne njëkohësisht nxisim ndërrimet strukturore në ekonomi, duke i kushtuar vëmendje shtimit të prodhimtarisë dhe nxjerrjes së prodhimeve në treg, duke mundësuar që ne të jetojmë nga puna jonë dhe që taksat të jenë në funksion të prodhimtarisë dhe të përparimit të sistemit arsimor, shëndetësor dhe të politikave sociale. Kosova edhe këtë vit po vazhdon me investimet kapitale, po e vazhdon procesin e privatizimit, duke i futur paratë e fituara në këtë mënyrë në politikën zhvillimore, duke mbrojtur njëkohësisht interesat e punëtorëve, por edhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Reformat në arsim, shëndetësi, në shkencë, ndërrimi i strukturës së ekonomisë dhe përshtatja e saj me trendet globale është e mundshme me një menaxhim më të mirë të

buxhetit, me politikat e drejta fiskale dhe me nxitje të degëve zhvillimore të ekonomisë, duke rritur cilësinë dhe duke ndjekur parametrat e vendeve të zhvilluara evropiane.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të jesh Presidente në këtë kohë është një nder, por edhe një përgjegjësi e madhe. Këtë punë unë do ta kryej në bashkëpunim dhe në ndihmë të ngushtë me të gjithë juve. T'i shfrytëzojmë këto vite të tranzicionit për të bërë reforma të gjithanshme, për të përshtatur legjislacionin me Bashkimin Evropian, për të fituar udhëzimin për liberalizimin e vizave dhe mekanizmin e qartë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Kosova, për shkak të asaj që përjetoi populli i saj, për shkak të prezencës më shumë se dhjetëvjeçare të misionit civil ndërkombëtar, të misionit ndërkombëtar ushtarak, nuk duhet të mbesë mbrapa vendeve të tjera në procesin e integriteteve evro-atlantike. Ky atëherë do të ishte edhe një dështim i angazhimit ndërkombëtar në Kosovë dhe për Kosovën.

Kosova, ashtu sikur i gjithë Ballkani Perëndimor, e ka vendin në Bashkimin Evropian. Me këtë përmbyllet një rrugë e gjatë shekullore e përpjekjeve të popullit të këtij rajoni në civilizimin evropian.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Në rrugën tonë jemi krenarë në lavdinë, jemi krenarë në shëmbëlltyrën e Skënderbeut, në personalitetin e Nënës Terezë, në aktin sublim të Adem Jasharit dhe në veprimtarinë e Ibrahim Rugovës. Të gjitha këto personalitete, si dhe shumë e shumë të tjerë, gjatë shekujve dhe në ditët tona, interesin e vendit dhe të popullit e vunë para vetes dhe me dritën e veprës së tyre shndritën deri në ditët tona e do të shndrisin edhe në të ardhmen, duke e përcaktuar qartë rrugën tonë, përkushtimin dhe idealin për të qenë të ndershëm, për të qenë të dinjitetshëm të lirë dhe të barabartë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në punën dhe detyrën time do të udhëhiqem nga Kushtetuta dhe nga ligjet e Republikës së Kosovës. Do të jem transparente dhe bashkëpunuese në të gjitha çështjet. Do të jem faktor dhe simbol i unitetit. Do të përfaqësoj dinjitetshëm e me përgjegjësi Republikën e Kosovës, interesat e të gjithë qytetarëve.

Ju faleminderit!

Hvala vam!

Teşekkürler!

Thank you!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Falënderoj presidenten për fjalën e rastit!

Edhe një herë, në emër të Kuvendit, i uroj detyrën e posa marrë. Pas një pauze prej 20 minutash, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Miratimi i Rezolutës në mbështetje të Memorandunit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.**

Grupet parlamentare të Aleancës Kosova e Re, të Lidhjes Demokratike dhe të Partisë Demokratike kanë proceduar në Kuvend Propozim-rezolutën në mbështetje të Memorandunit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Ftoj deputetin Ibrahim Makolli, që në cilësinë e propozuesit të Rezolutës të paraqesë para deputetëve Propozim-rezolutën në mbështetje të Memorandunit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Në sallë janë 67 deputetë.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me propozim të grupeve parlamentare të PDK-së, të LDK-së dhe të AKR-së, Kuvendi miraton këtë:

**R E Z O L U T Ë**

Në mbështetje të Memorandunit të Marrëveshjes ndërmjet zotit Behgjet Pacolli, zotit Isa Mustafa dhe zotit Hashim Thaçi:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkrahjen e tij për Memorandumin e Marrëveshjes ndërmjet zotit Behgjet Pacolli, zotit Isa Mustafa dhe zotit Hashim Thaçi, më tej: Memorandumi, të arritur më 6 prill 2011, dhe mbështet plotësisht zotimet e përmbajtura në të.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që Presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhët në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli.

Kuvendi mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum, sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se 6 muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi.

Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit, i identifikuar nga koalicioni qeverisës për këtë qëllim, ashtu siç është paraparë në Memorandum.

Në pajtueshmëri me memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 6 deri në 9 muaj, nga data e themelimit.

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum, që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe të legjislacionit, të ndërlidhur që, mes tjerash, do të përkrahim krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë.

Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit, i identifikuar nga partitë opozitare për këtë qëllim, ashtu siç është paraparë në Memorandum.

Në pajtueshmëri me memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 8 deri në 12 muaj nga dita e themelimit.

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum, sipas të cilit zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë, sipas Ligjit të amendamentuar për zgjedhjet e përgjithshme, do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.

5. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet themelimin e komisioneve të lartpërmendura të nevojshme për proceset kushtetuese dhe legjislative, në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Prishtinë, më 7 prill 2011.

KRYETARI: Faleminderit! Konsideroj që grupet që e mbështesin këtë, s'kanë nevojë për të marrë fjalën. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Në sallë janë 81 deputetë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Aleanca mendon se presidenti është i Kosovës dhe kjo është arsyeja pse sot ka qëndruar në sallë dhe me shumicë të votave të veta ka votuar presidenten e re.

Mirëpo, në të njëjtën kohë, mendon se kjo që po ndodh tash, në pikën e dytë të rendit të ditës, është diçka tjetër.

Vullneti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk shtrihet përtej bindjes se vendit i duhet presidenti.

Kjo pikë e dytë e rendit të ditës është ajo me të cilën nuk pajtohem dhe nëse ajo e para mund të quhet, në parim, lajm i mirë për popullin e Kosovës, kjo e dyta është lajm shumë i keq për popullin e Kosovës, për shkak se përmes këtij të ashtuquajturit memorandum, i zgjatet jeta qeverisjes së keqe në Kosovë.

Ne sot nuk e votojmë këtë marrëveshje të tri partive dhe ju premtojmë se kjo marrëveshje e tri partive nuk do të mund të zgjasë aq sa tri partitë e kanë paraparë të zgjasë.

Aleanca, po ashtu, nuk do të jetë dëshmitare e këtij votimi, po e shihni, do të jemi jashtë sallës kur ky votim do të bëhet dhe në të njëjtën kohë mendojmë se ky i ashtuquajtur memorandum, që sot do të votohet, është po ashtu në kundërshtim me frymën kushtetuese në Kosovë.

Ky memorandum, edhe një herë po ju them, vetëm sa e zgjat qeverisjen e keqe në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Ardian!  
Arsim Bajrami e ka kërkuar fjalën!

ARSIM BAJRAMI: I nderuar, kryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke i dhënë mbështetje kësaj projektrezolute, dëshiroj të sqaroj vetëm një rrethanë, rrethanë legale dhe kushtetuese. Është e drejtë e plotë kushtetuese e Kuvendit të Kosovës që të miratojë rezoluta politike, sepse në kapacitetin e vendimmarrjes politike rezolutat janë qëndrime politike dhe në këtë rast tri partitë politike kanë ndërtuar një qëndrim politik për një agjendë reformuese, kushtetuese dhe legjislative, por vetëm sa për të sqaruar, ndoshta edhe kolegun paraprak që foli, duhet të kemi të qartë se ky është një vullnet politik, një pëlqim politik. Pasojat juridike të këtij pëlqimi do të fillojnë të rrjedhin nga dita e ndryshimeve kushtetuese dhe ndryshimeve legjislative. Ky edhe ka qenë qëllimi i arritjes së kësaj marrëveshjeje që praktikisht Kuvendi të futet në një agjendë reformuese, në procesin e reformës kushtetuese dhe reformës legjislative, por pasojat konkrete do të rrjedhin me rastin e ndryshimeve kushtetuese, kur amendamentet kushtetuese do të përcaktojnë qartazi afatet në bazë të kësaj dinamike që është përcaktuar në këtë pajtim që i kanë arritur tri partitë politike. E njëjta gjë vlen edhe për agjendën e ndryshimit të Ligjit zgjedhor. Janë dhënë këto termine dhe afate dhe ne tani më tepër kemi një agjendë orientuese, por pasojat juridike dhe kushtetuese të këtij memorandumi fillojnë të prodhojnë pasoja juridike që nga momenti i miratimit të amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sa i përket fillimit të procesit të zgjedhjeve presidenciale, kurse pasojat juridike të shkuarjes në zgjedhje të reja parlamentare fillojnë të rrjedhin nga dita e miratimit të ligjit, të Ligjit të ri zgjedhor, i cili mund të parashehë në dispozitat e tij ose kalimtare ose në dispozitat e tjera afatet eventuale të mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme parlamentare dhe presidenciale.

Dola, thjeshtë, vetëm për të sqaruar këtë efekt juridik, ndoshta edhe për hir të opinionit, për shkak se këto ditë ka pasur spekulime që mos ky memorandum është ngritur mbi Kushtetutën. Jo, nuk është ngritur mbi Kushtetutën. Thjeshtë, ka caktuar një platformë politike, një pëlqim politik për të hyrë në një agjendë të ndërrimeve kushtetuese dhe legislative. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedniče!

Ja bih ispred Parlamentarne grupe „6+“ izrazio jedno veliko nezadovoljstvo zbog toga što mi nismo bili učesnici u ovom sporazumu i smatramo da smo trebali uzeti učešće. Tako, u budućе, ispred Parlamentarne grupe „6+“ tražim da mi budemo uključeni u daljem procesu.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi të tjerë të lajmëruar për diskutim. Atëherë, hyjmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Në sallë janë 87 deputetë.

Me 75 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 “abstenime”, Kuvendi miratoi Rezolutën në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacollit, z. Isa Mustafës dhe z. Hashim Thaçit, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve**